

AUTO STAR ALBANIA SH.A

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

PËRMBAJTJA

	Page
RAPORTI AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL NETO	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-31

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerin e Shoqërisë Auto Star Albania sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Auto Star Albania sh.a (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe të masave kufizuese të lidhura me kompaninë. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bërë nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

mazars

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse pjesëtarëve të tjerë, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

mazars

Erin Durruti Str., Binjaket Build,
No.5, 10131, Tirana, Albania
MIS: K327270000


Irena Hoxha (Pulo)
Auditor Ligjor

07 Qershor 2021

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktivot afatgjata			
Aktivot afatgjata materiale	6	1,535,522,690	1,525,273,524
Aktivot afatgjata jomateriale	7	2,240,408	3,169,489
Totali i aktiveve afatgjata		1,537,763,098	1,528,443,013
Aktivot afatshkurtra			
Inventarë	8	831,649,402	1,209,501,946
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	751,014,757	462,723,096
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	27	51,082,148	69,291,902
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	323,247,838	253,034,103
Tatim fitimi parapaguar	26	17,741,518	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	25,892,380	13,835,385
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,000,628,043	2,008,386,432
Totali i aktiveve		3,538,391,141	3,536,829,445
KAPITALI			
Kapitali aksionar		1,140,000,000	1,140,000,000
Rezerva ligjore		6,294,988	6,294,988
Fitime të mbartura		173,240,482	63,849,803
Fitimi i ushtrimit		(10,593,446)	109,590,679
Totali i kapitalit	12	1,308,942,024	1,319,535,470
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	13	713,777,758	753,814,261
Totali i detyrimeve afatgjata		713,777,758	753,814,261
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	866,528,941	818,904,940
Llogari të pagueshme tregtare	14	494,466,749	438,979,977
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	27	62,069,628	122,650,764
Parapagimet e arkëtuara	15	38,428,165	43,594,593
Detyrime për tatimin mbi fitimin	26	-	6,079,267
Detyrime tatimore	16	22,333,591	18,661,852
Llogari të pagueshme të tjera	17	31,845,285	12,718,321
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,515,671,359	1,463,479,714
Totali i detyrimeve		2,229,449,117	2,217,293,975
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,538,391,141	3,536,829,445

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	2,306,230,384	2,530,804,699
Të ardhura të tjera	19	18,148,744	115,868,507
Total të ardhura		2,324,379,128	2,646,673,206
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(1,936,404,584)	(2,079,656,868)
Shpenzime personeli	21	(106,131,750)	(116,548,801)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	22	(81,229,374)	(71,672,375)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(140,282,355)	(215,589,423)
Total shpenzime		(2,266,048,063)	(2,483,467,267)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	24	(40,729,880)	(46,946,320)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	25	(23,049,924)	18,006,107
Fitimi para tatimit		(5,448,739)	134,265,726
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(5,144,707)	(24,675,047)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	26	(5,144,707)	(24,675,047)
Shpenzimi aktual i tatimit të shlyrë		-	-
Fitimi i vitit		(10,593,446)	109,590,679
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(10,593,446)	109,590,679

Pasqyra financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëuese nga faqja 8 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Auto Star Albania sh.a

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali aksionar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / (Humbla) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	1,140,000,000	6,294,988	(8,299,206)	71,949,009	1,208,944,791
Transferim në fitime të mbartura			71,949,009	(71,949,009)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse të rëkëlluara për vitin:				109,590,679	109,590,679
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	1,140,000,000	6,294,988	63,649,803	109,590,679	1,318,535,470
Transferim në fitime të mbartura			109,590,679	(109,590,679)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				(10,593,446)	(10,593,446)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	1,140,000,000	6,294,988	173,240,482	(10,593,446)	1,308,942,024

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 8 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më 25 mars 2021 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Z. Florenc Pula

Përgjithësi i pasqyrave financiare

Z. Arben Broshani

Administrator

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fluksot e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(5,448,739)	134,265,726
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizimi	81,229,374	71,872,376
Zhvlerësimi		
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital	24,900,134	(3,480,321)
Tatimi mbi fitimin	(5,144,707)	(24,675,047)
Ndryshimi në kapitalin qarkullues		
Rënie/(rritje) në inventar	377,852,544	(391,405,090)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(358,037,161)	(43,129,623)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	9,734,072	(340,363,975)
Rritje/(rënie) në paracagime të arkëtuara	(5,166,428)	4,280,992
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	119,919,089	(592,835,162)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(115,449,592)	(53,271,648)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	-	24,079,374
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(115,449,592)	(29,192,274)
Aktivitetet financuese		
Ripagimi i huas afatgjata	(40,036,503)	650,964,302
Te hyrat/(ripagim) neto në huas afatshkurtra	47,824,004	(43,470,909)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financiar	7,587,498	607,493,393
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	12,056,995	(14,534,043)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	13,835,385	28,369,428
Mjetet monetare në fund të periudhës	25,892,380	13,835,385

11

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

AUTO STAR ALBANIA sh.a (Kompania) është themeluar si një shoqëri aksionare më 2 Gusht 1996 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare".
Kapitali aksionar i shoqërisë është 1,140,000,000 Lekë (një miliard e njëqind e dyzet milion Lek) dhe zotërohet nga ortakët i vetëm, KASTRATI Group sh.a me pjesëmarrje në përqindje 100%.

Vepërimitaria kryesore e shoqërisë është importi, eksporti dhe tregtimi me shumicë apo pakicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e autovekurave, mjeteve të transportit të pasagjerëve, kamionëve dhe transportierëve të tjerë dhe pjesë këmbimi.

NIPT-i i shoqërisë është J620230076.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës, Km 7, godina 2 katëshe, nr 10.

Deri më datë 04.03.2020, administratori i Shoqërisë ka qënë Z. Musa Kastrati dhe me vendimin e datës 04.03.2020 është emëruar administratori i ri Znj. Elida Shehu, e cila me vendimin e datës 24.03.2020 është zëvendësuar nga Z. Arben Breshani.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 80 punonjës (2019: 101 punonjës). Numri i punonjësve në fund të vitit 2020 i ndarë sipas kategorive është:

- 1 administrator
- 4 drejtorë
- 68 staf administrativ
- 15 staf në shitje

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste menaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Menaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Përkufizimi i një biznesi (Amendime në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialitetit (Amendime në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Standarde të Ndryshme)
- Konçensionet të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

3.2 Standardet dhe interpretimet e ematuara por ende të pa përvetësuara

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbylltur më 31 dhjetor 2020:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përmbyshjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/Lek	100.84	108.64

4.2 Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentat e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me kostot e amortizuara (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portfolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja fluksot e mjeteve monetare kontraktuale dhe fluksat e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arritur flukse mjeteshe monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktoret që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivitet financiar – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë votën pagosat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin votën konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parashë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFI. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rievluar më pas. Referojuni Shënimit 6 për gjykimet kritike të aplikuar nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivitet financiar – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësisë ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkolle të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paafësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që orde i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivitet financiar – çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'u paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisë ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk men thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFI. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare – regjistrimi. Detyrimet financiare regjistrohen kur ato shihen (dmth, kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohen shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe përshkruhet më së miri nga një çmim aktiv i kushtuar tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostojë e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllëgaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kreditës për aktivet financiare.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parësë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parësë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së kostos së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar rrlhet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas rrahjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historiko, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Politikat Kontabil (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Ritimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëparshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabil të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orëndi	Vlera e mbetur	20%
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zëri i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Ritimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Aktivat me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thellë të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalese.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësive ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit me të drejtë përdorimi dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin me të drejtë përdorimi kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësive ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkupohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesat e ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 shoqëria nuk kishte asnjë kontratë qiraje që blinte në kushte zbatuese të SNRF 16.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.6. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiv do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tjerët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëposhme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Aktivët jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

4.7. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur me që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.8. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Koston e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen fluksa dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksot e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.14. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. Gjykimet dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemi material në shumën e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumën e cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Sic është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare.

Llogaritja e arketueshme të kompanisë përshlyen vetëm një dalje të mjeteve monetare, pagesën e vlerës që rezulton nga transaksioni në lidhje me SNRF 15, i cili konsiderohet të jetë kryesor. Prandaj, daljet e mjeteve monetare nga llogaritja e arketueshme janë në përputhje me modelin e biznesit pavarësisht komponentit të interesit duke qenë zero.

Gjykimet dhe vlerësimet mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parash dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Auto Star Albania sh.a

Shënimet mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Leke)

6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale përbehen si më poshtë:

Kosto	Toka	Ndërtuesia	Makinieri che Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Ërë tjera	Mobilje e pajisje zyre	Asete në proçes	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	616,000,000	1,210,117,587	165,051,807	87,577,327	4,185,779	62,213,329	2,210,001	2,002,380	2,069,304,250
Shëtitje		4,722,233		9,062,175	2,080,964		40,958,278		53,271,648
Transferime							2,002,390	(2,002,380)	-
Pulsiime			(1,042,468)	(25,447,376)					(26,489,844)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	616,000,000	1,120,117,587	165,181,572	71,182,120	6,266,748	62,218,329	45,171,607	-	2,086,163,054
Transferime			11,398,371	90,857,000	811,108		8,932,573		115,449,502
Pulsiime				(28,976,108)					(28,976,108)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	616,000,000	1,120,117,587	175,549,943	158,615,538	7,077,871	62,218,329	52,104,270	-	2,172,576,536
Amortizimi i akumuluar									
Gjendja më 1 janar 2019	-	324,342,328	105,385,306	57,231,402	2,086,240	31,278,171	973,778		486,017,226
Amortizimi i vitit		39,775,763	11,635,313	14,181,341	-	41,927	7,905,741		70,713,285
Kthim amortizimi			(151,054)	(5,736,807)					(5,887,861)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	364,321,092	117,065,555	37,195,016	2,086,240	31,320,098	8,879,519	-	503,869,530
Amortizimi i vitit		37,169,029	10,509,523	17,471,401	1,284,078	37,734	13,197,732		80,300,203
Pulsiime				(4,010,875)					(4,010,875)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	402,110,917	127,575,088	50,651,442	3,380,318	31,367,832	22,077,251	-	637,153,046
Koha neto kontabël									
Gjendja më 31 dhjetor 2019	616,000,000	795,785,495	43,115,007	83,996,110	4,180,503	30,883,231	38,292,178	-	1,525,273,524
Gjendja më 31 dhjetor 2020	616,000,000	713,000,670	48,973,855	87,962,096	3,687,563	30,860,497	30,027,019	-	1,535,522,690

7. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale e paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	6,193,871	6,193,871
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	6,193,871	6,193,871
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	6,193,871	6,193,871
Zhvlerësimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2019	2,095,301	2,095,301
Zhvlerësimi i vitit	929,081	929,081
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,024,382	3,024,382
Zhvlerësimi i vitit	929,081	929,081
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,953,463	3,953,463
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	3,169,489	3,169,489
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	2,240,408	2,240,408

8. Inventari

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Makina për rishitje	661,119,969	1,010,200,663
Pjesë këmbimi	170,529,433	159,599,478
Goma	-	39,701,805
	831,649,402	1,209,501,946

9. Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Klientë	751,014,757	483,648,657
Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme	-	(20,825,571)
	751,014,757	462,823,086

10. Llogaritë të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TVSH për tu rregulluar	1,399,306	1,766,657
Hua dhënë të tregjeve	234,703,350	205,252,034
Parapagime dhe garanci	63,514,845	7,168,937
Të tjera të arkëtueshme	23,570,328	38,845,475
	323,247,838	253,034,103

11. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	8,974,575	12,315,325
Në lek	5,586,038	6,217,803
Në valutë	1,408,537	6,097,522
Mjete monetare në arkë	18,917,805	1,520,060
Në lek	8,087,807	414,396
Në valutë	12,829,998	1,105,664
	25,892,380	13,835,385

12. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 1,140,000,000 leke.

Rezerva ligjore e kompanisë është në vlerën 5,294,988 lekë. (2019: 6,294,988 Lekë)

Fidmet e mbartura janë në vlerën 173,240,482 lekë. (2019: 83,649,803 Lekë)

Shuma prej (10,593,446) Lekë përfaqëson humbjen përgjatë vitit 2020. (2019: Fitimi ushtrimi 103,590,678 Lekë).

13. Huatë

Huaja detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Overdraft Raiffeisen Bank	360,163,674	306,246,194
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë nga Raiffeisen Bank	67,858,480	101,474,994
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë nga Tirana Bank	147,807,279	139,165,897
Hua afatshkurtër nga palët e lidhura	265,614,422	206,349,398
Interesa të përlogaritura për huasë nga banka	92,101	5,668,657
Kredi qarkullues	11,454,546	-
Qera financiare	4,438,459	-
Pjesa afatgjatë e qerasë financiare	18,771,070	-
Pjesa afatgjatë e huasë nga Tirana Bank	695,006,688	763,814,261
	<u>1,580,306,699</u>	<u>1,572,719,201</u>

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	493,576,196	439,447,945
Furnitorë për fatura të pambëritura	889,553	532,032
	<u>494,465,749</u>	<u>439,979,977</u>

15. Parapagimet e arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime të marra	16,625,881	16,788,956
Parapagime për automjete	21,802,284	26,805,638
	<u>38,428,165</u>	<u>43,594,593</u>

16. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,817,135	2,055,741
Tatim në buvim	13,875	13,900
Detyrim për tatimin mbi të ardhurat personale	706,639	822,614
TVSH e pagueshme	19,793,942	15,758,587
	<u>22,333,591</u>	<u>18,651,852</u>

17. Llogaritë të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga të pagueshme	1,491,439	7,138,321
Detyrime të tjera	30,353,848	5,580,000
	<u>31,845,285</u>	<u>12,718,321</u>

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shitje e automjeteve	1,738,580,129	1,815,997,839
Të ardhura nga shërbime dhe pjesë këmbimi	559,971,444	699,835,507
Të ardhura nga qiradhënia e makinave	9,578,811	14,971,353
	<u>2,306,230,384</u>	<u>2,530,804,699</u>

19. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shërbime të tjera	11,470,016	110,842,386
Të ardhura të tjera	2,294,727	1,545,599
Rezultati nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	4,984,001	3,480,522
	<u>18,148,744</u>	<u>115,868,507</u>

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Kosto e mallrave të shitur	1,936,404,584	2,079,656,868
	<u>1,936,404,584</u>	<u>2,079,656,868</u>

21. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime paga	91,456,729	102,309,495
Shpenzime për sigurime shoqërore	13,233,021	14,239,106
Shpenzime për fond pensioni vullnetar	3,422,000	-
	<u>108,111,750</u>	<u>116,548,601</u>

Numri mesatar i punonjësve përgjatë vitit 2020 ishte 88.

22. Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime amortizimi	81,229,374	71,672,375
	<u>81,229,374</u>	<u>71,672,375</u>

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje energji, avull, ujë, karburant	16,668,620	15,895,028
Sigurime	7,239,872	6,578,834
Shpenzime tjerave	995,084	3,033,252
Mirëmbajtje	17,195,376	29,972,867
Humbje nga shitja nën kosto	2,848,957	673,112
Transferime, udhëtime, dieta	464,303	1,739,428
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,794,070	2,112,791
Shpenzime bankare	20,334,776	18,407,930
Shpenzime doganore	3,910,691	10,663,863
Shpenzime transporti	2,216,628	45,954,321
Shpenzime të tjera	2,357,255	16,797,989
Shpenzime për tatim taksë	15,023,942	16,981,600
Shpenzime pritje përçeljeje	7,705,178	1,585,310
Shpenzime të panjohura	21,647,089	5,715,219
Ujëba	891,212	4,227,527
Shtetësi nga të tretë	7,042,757	12,565,303
Blerje të ndryshme, kancelari, etj	438,423	1,116,528
Uniforma për punonjësit	2,236,334	640,750
Shpenzime marketingu dhe sponsorizime	1,268,315	6,542,467
Shpenzime informatike	1,940,973	7,890,304
Shpenzime sigurie	6,062,500	6,585,000
	140,282,355	215,589,423

24. Shpenzime Interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet e Interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime Interesi	40,729,880	46,946,320
	40,729,880	46,946,320

25. Shpenzime të tjera financiare neto

Humbjet nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitimi nga kursi këmbimit	4,678,445	31,443,552
Humbja nga kursi këmbimit	(27,728,369)	(13,437,445)
	(23,049,924)	18,006,107

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Fitimi para tatimit</i>	<i>(5,448,739)</i>	<i>134,265,726</i>
Total shpenzime të panjohura	39,746,785	30,234,586
Penalitetë, gjoba e dëmtqërbime	891,212	4,227,527
Shpenzime amortizimi	17,202,644	19,310,318
Shpenzime të tjera	21,652,929	6,696,741
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	34,298,048	164,500,312
Humbje fiskale e mbartur		
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<i>5,144,707</i>	<i>24,675,047</i>
	(10,593,446)	109,590,679
	2020	2019
Gjendja më 1 janar	(6,979,267)	(878,326)
Pagesa të kryera gjatë vitit	29,965,492	18,574,106
Shpenzimi tatim fitimit	(5,144,707)	(24,675,047)
Detyrimi për tatim fitimin më 31 dhjetor	17,741,518	(6,979,267)

27. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Huamarrje	-	266,614,422	-	206,349,398
Kastrati Group sh.a	-	-	-	-
Ortaku Sh. Kastrati	-	32,656,800	-	32,147,280
Kastrati Residences	-	23,306,600	-	23,306,600
Kastrati Construction	-	101,423,609	-	94,980,600
Kastrati Hotels and Tower	-	32,267,380	-	32,267,380
Albsig sh.a	-	70,578,025	-	18,265,530
Mak Albania sh.a	-	5,382,008	-	5,382,006
Marrëdhënie tregtare	51,082,148	62,069,628	69,291,902	122,650,764
Kastrati Group sh.a	-	56,017,390	-	77,586,957
KST Advertising shpk	-	2,337,186	2,182,912	1,262,731
Kastrati shpk	6,737,410	-	31,648,751	24,306,769
Albanian High Concession	-	-	2,354,513	-
Kastrati Construction	4,539,028	-	519,094	-
Albsig sh.a	37,322,950	3,616,104	9,840,568	1,989,231
Continental group	-	-	1,447,617	8,250,076
Kastrati Hotels and Tower	2,482,760	98,948	775,266	-
Kastrol sh.a	-	-	223,181	9,156,000
	51,082,148	327,884,050	69,291,902	329,000,162

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Kastrati Group sh.a	33,849,843	129,810	159,790,314	-
KST Advertising shpk	10,389,984	895,378	5,205,803	2,227,752
Kastrati shpk	13,386,217	14,054,698	13,680,234	9,585,737
Kastrati Hotels and Tower	82,828	98,847	2,371,614	-
Albanian High Concession	1,680,093	-	2,636,298	-
Kastrati Construction	3,336,888	-	297,736	-
Albsig	39,551,993	3,060,133	24,326,990	2,550,921
Continental group	4,970,591	2,954,911	4,858,767	3,849,416
	107,248,437	21,193,678	213,167,776	18,213,826

Përveç përfitimave afatshkurtra ndaj ekipit menaxhues të Shoqërisë, në shumën 4,214,022 Lekë nuk janë dhënë kompensime të tjera ndaj menaxhimit.

28. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbanqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiarë të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdonura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktivitetëve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktivitetëve të saj financiare, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumentat të tjerë financiarë.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

28. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i cenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të biera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për njëte monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2020			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	787,741,320	337,603,423		1,125,344,743
Mjete monetare në arkë dhe bankë	25,892,380			25,892,380
Totali	813,633,700	337,603,423	-	1,151,237,123
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(427,499,977)	(183,214,276)		(610,714,253)
Hua	(433,264,471)	(433,264,471)	(713,777,758)	(1,580,306,699)
Totali	(860,764,447)	(616,478,746)	(713,777,758)	(2,191,020,952)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2020	(47,130,747)	(278,875,323)	(713,777,758)	(1,039,783,829)

Përshkrimi	31 dhjetor 2019			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	844,779,730	181,194,934		1,025,974,672
Mjete monetare në arkë dhe bankë	13,895,385			13,895,385
Totali	858,675,115	181,194,934	-	1,039,870,057
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(480,794,145)	(120,195,036)		(600,989,181)
Hua	(409,452,470)	(409,452,470)	(753,814,261)	(1,572,719,201)
Totali	(890,236,615)	(529,647,506)	(753,814,261)	(2,173,699,352)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	(31,561,492)	(348,452,572)	(753,814,261)	(1,353,889,325)

2B. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i monedhës**

Shoqëria ndermerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj lloqjeve të kursave të këmbimit. Ekspozimi ndaj kursave të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë mblis të arkëtueshme dhe të pagueshme. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2020			
	EUR	ALL	USD	GBP
Llogarit tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	872,392,316	252,952,427	-	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	14,142,583	11,653,881	87,256	8,560
Totali	886,534,999	264,606,308	87,256	8,560
Llogarit tregtare të pagueshme dhe të tjera	(369,542,323)	(241,171,930)	-	-
Hua	(1,411,963,348)	(168,343,351)	-	-
Totali	(1,781,505,671)	(409,515,281)	-	-
Rezultu i monedhës më 31 dhjetor 2020	(894,970,672)	(144,908,973)	87,256	8,560
				(1,039,793,929)

Përshkrimi	31 dhjetor 2019			
	EUR	ALL	USD	GBP
Llogarit tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	559,241,245	252,733,427	-	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	6,894,389	6,632,234	46,417	461,745
Totali	559,936,234	259,365,661	46,417	461,745
Llogarit tregtare të pagueshme dhe të tjera	(133,953,302)	(467,028,879)	-	-
Hua	(1,506,094,556)	(65,524,645)	-	-
Totali	(1,640,047,858)	(933,651,524)	-	-
Rezultu i monedhës më 31 dhjetor 2019	(1,080,111,624)	(274,285,863)	46,417	461,745
				(1,353,889,325)

29. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

30. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al